



Republika e Kosovës \* Republic of Kosova  
Komuna \* Municipality  
Hani i Elezit



DATE: 03.04.2024

NR.09/ 2597/2024

## KONTRATË PËR FURNIZIM

Numri i kontratës <sup>1</sup>: 659-24-1662-5-5-8/C510: KKHE-24-011-5-5-8

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë; dhe  
ARITECH, PRISHTINË - LIPJAN KM.10- PËRBALLË QMI- SË, GRACANICA, (në vazhdim  
"Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Furnizim me laptop - Model III me numër identifikues: 659-24-1662-5-5-8

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
1	Furnizim me laptop - Model III

### Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 10 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë Komuna Hani i Elezit. Furnizim me laptop - Model III

2.3 Inkotermi<sup>2</sup> i zbatueshëm do të jetë

### Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

### Neni 4 Cmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë; 595.00 €; [Peseqinde e nëntëdhjetë e pesë/00 cent] Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtrohen ndryshimeve]

Cmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: [shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

<sup>2</sup> Incoterms 2010 Oda Ekonomike Nderkombëtare

## Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

### 5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe<sup>3</sup> në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

### Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Xhevdet Bushi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i pranimit
Nënshkrimi:	
Data:	04.04.2024
Vula:	

### Për Furnizuesin

Emri:	Avni Mehani
Pozita:	Perfaqësues
Nënshkrimi:	
Data:	04.04.2024
Vula:	

<sup>3</sup>Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-24-1662-5-5-8/C510

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

<b>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</b>		<b>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</b>
<b>Përshkrimi i nenit</b>	<b>Nr. Neni</b>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Siguria e ekzekutimit	9.1	Sigurimi i ekzekutimit të kontratës në 10% e vlerës së kontratës me afat prej 40 diteve
Sigurimi	10.1	Sigurimi i ekzekutimit të kontratës në 10% e vlerës së kontratës me afat prej 40 diteve
Programi i ekzekutimit	11	<i>Kohëzgjatja e kontratës është 10 dite nga nënshkrimi i saj. Pra, furnizimi duhet të realizohet brenda 10 diteve nga kërkesa që AK- Komuna Hani i Elezit i drejtohet OE-se në fjalë, ashtu siq është percaktuar në dosje të tenderit.</i>
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	<i>[Shëno kushtet e dorëzimit]</i>
Patentat dhe licencat	13.1	<i>[Specifikoni nëse ka ndonjë shmangie nga Neni 13 i KPK]</i>
Vonesat në ekzekutim		Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.
Cilësia e furnizimeve	18.2	<i>Laptopet dhe pajisjet tjere duhet të jene konform kerkeseve te dosje se tenderit –dhe specifikave te percaktuara tek marrveshja publike kornize</i>
Inspektimi dhe testimi	19.2	<i>Furnizimi do te kontrollohet per cilesi dhe sasi dhe me pas do te pranohet nga AK –nese eshte konform kushteve te kontrates –sipas obligimeve</i>
Menaxheri i kontratës	19.3	<i>Menaxheri i kontrates do te cakohet me vendim te ZKA-së</i>
Pagesa	20.1	<i>Pagesa do te behet pas realizimit te furnizimit te percaktuar tek lista e artikujve.] Pagesa do te behet brenda aftit ligjor pas pranimit te furnizimit i pranuar nga AK</i>
Dorëzimi	21.3	<i>Furnizimi artikujt duhet te jene te reja , te behet konform listes qe jane percaktuar tek lista e artikuve ku furnizimit ne paketime adekuate</i>
Obligimet e garancionit	24.1	<i>3 vite apo 36 muaj nga koha e pranimit te laptopve dhe paisjeve tjera nga AK-Komuna Hani i Elezit</i>
	24.5	<i>3 vite apo 36 muaj nga koha e pranimit te laptopve dhe paisjeve tjera nga AK-Komuna Hani i Elezit</i>
Shërbimet pas shitjes	25.1	<i>3 vite apo 36 muaj nga koha e pranimit te laptopve dhe paisjeve tjera nga AK-Komuna Hani i Elezit</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Permes procedurave alternative per zgjidhjen e mos-marreveshjeve
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[Gjykate Komercele -Prishtinë]</i> në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</i>